

D E K R E T
Nr.1278, datë 10.11.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 "PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT DOGANORE""**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7936, datë 18.5.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifatat doganore", në nomenklaturën e mallrave 1995, tarifa doganore për kërret 0202.30 dhe 0203.29 ndryshohen si më poshtë:

- Nënkreu 0202.30 - Prerje pa kocka (mish gjedhësh, i ngrirë)... 25%
- Nënkreu 0203.29 - Prerje të tjera (mish derri, i ngrirë pa kocka)... 25 për qind.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.8040, datë 30.11.1995 të Kuvendit Popullor.